VENDIM
Nr. 26, datë 18.1.2017

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NR. 2 TË MARRËVESHJES SË GRANTIT NR.TF013972, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM/SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA DHURUES TË NDRYSHËM, NËN FONDIN E DYTË TË BESIMIT SHUMËDHURUES PËR SHQIPËRINË, PËR MBËSHTETJEN PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR (SPI) 2

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit nr. 2 të marrëveshjes së grantit nr. TF013972, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën fondin e dytë të besimit shumëdhurues për Shqipërinë, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar (SPI) 2, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

1818 H Street N.W.
Washington, D.C. 20433
U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa kabllore: INTBAFRAD
Adresa kabllore: INDEVA

24 gusht 2016

Shkëlqesisë së Tij, Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Republika e Shqipërisë

Lënda: Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve shqiptare për Zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI)2
Granti nr. TF013972
Ndryshimi nr. 2 i Marrëveshjes së Grantit

Shkëlqesi,

Ne i referohemi marrëveshjes së grantit, të datës 7 mars 2013 si (Marrëveshje), e ndryshuar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (Banka Botërore), në datën 7 mars 2013, e ndryshuar, për Fondin e Besimit me Shumë Donatorë për Mbështetje për Ngritjen e Kapaciteteve Shqiptare për Zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI)2 (Projekti) dhe letrës suaj, të datës 2 nëntor 2015, ku i kërkoni Bankës Botërore të shtyjë Datën e Mbylljes për Grantin e cituar më sipër sipas Marrëveshjes.

Në lidhje me sa më sipër dhe diskutimet tona më të fundit, Banka Botërore propozon të amendojë Marrëveshjen për të shtyrë Datën e Mbylljes dhe të përditësojë politikat e zbatueshme të prokurimit.

Në përputhje me këtë, Marrëveshja amendohet si vijon:

1. Paragrafët "i" dhe "ii" të seksionit 2.07(a) të Marrëveshjes janë amenduar këtu dhe janë zëvendësuar tërësisht, duke u lexuar si vijon:

"i) Seksioni I i "Udhëzime: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve jo-të konsulencës sipas kredive IBRD dhe krediteve IDA dhe granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", i muajit janar 2011 (e rishikuar në korrik 2014) ("Udhëzime për prokurimet"), në rastin e mallrave dhe të shërbimeve jokonsulente;

ii) Seksionet I dhe IV të "Udhëzime: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas kredive IBRD dhe krediteve IDA dhe granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", të muajit janar 2011 (e rishikuar në korrik 2014) ("Udhëzime për konsulentët"), në rastin e shërbimeve të konsulentëve; dhe"

2. Seksioni 3.03 i Marrëveshjes është amenduar këtu dhe është zëvendësuar tërësisht, duke u lexuar si vijon:

"3.03. ***Periudha e tërheqjes.*** Data e mbylljes, e referuar në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde është 30 qershor 2018."

Të gjitha afatet dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes, me përjashtim sa është amenduar këtu, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem, konfirmoni pranimin tuaj në lidhje me amendamentin e mësipërm, duke e nënshkruar dhe vendosur datën në këtë letër, në hapësirën e dhënë më poshtë. Kjo letër amendamenti do të realizohet në dy kopje të njëjta, ku secila prej tyre do të jetë origjinale dhe njëra prej tyre do të kthehet te ne. Dispozitat e vendosura në këtë letër amendamenti do të hyjnë në fuqi në datën e njoftimit nga Marrësi për Bankën

Botërore në lidhje me përfundimin e procedurave të saj të brendshme.

Ju lutem vini re, gjithashtu se, shkresa ristrukturuese e datës 31 mars 2016, një kopje e së cilës është bashkëlidhur këtu, do të jepet në faqen zyrtare të jashtme të Bankës sipas politikës së Bankës mbi aksesin në informacion.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

Nga *(nënshkrimi)*
Ellen Goldstein
Drejtore e Vendit
Njësia e Vendeve të Europës Juglindore

PRANUAR:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga: _____

_____

Nënshkruani këtu

Titulli: _____
Data: _____
Bashkëlidhur